

Nr. .... Prot  
*Lutemi referoni këtë numër në përgjigje*

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_. 2022

## **Lënda : Kthim përgjigje**

Në përgjigje të kërkesës tuaj dt.26.10.2022 në postën elektronike :

### ***Pyetja :***

Së pari, falenderoj gadishmërinë dhe mirësjelljen e stafit të KESH për të më ndihmuar për të aksesuar raportet e finalizuara nga kontraktori sa i përket HEC Skavice.

Nga kjo vizite, e konsideroj të ezauruar pikën 1 a/b për aq kohë sa këto raporte akoma nuk mund të bëhen publike të plota, ndërsa sa i përket pikës 2, a/b, as gjatë vizitës nuk munda ta konsideroj të mbyllur. Kërkoj nga KESH ose të më ktheje përgjigje bashkë me lejet përkatëse, ose nqs nuk është KESH që e ka këtë informacion, të njoftojë institucionin që e ka për kërkesën time duke më vënë në dijeni, ashtu sic kërkohet në ligj.

### ***Përgjigje KESH sh.a. dt.28.10.2022 :***

Përsa i përket kësaj pyetje, leja per “Ndërtimin e rrugëve të aksesit për Hidrocentralin e Skavicës për realizimin e studimeve gjeologjike dhe gjeteknike” është miratuar në mbledhjen e KKT date 20.04.2022 dhe ende nuk është zbardhur. Sapo ky Vendim të jetë zbardhur do t’ju vihet në dispozicion nga ana jonë.

Faleminderit!